



GJENDJA FINANCIARE DHE HUAMARRJA E NDËRMARRJEVE NË SHQIPËRI

Gjashtëmuji i parë 2024

DEPARTAMENTI I STABILITETIT FINANCIAR

Gusht 2024

PËRMBAJTJA

<i>Përmbledhje e gjetjeve kryesore të vrojtimit.....</i>	<i>2</i>
<i>Gjendja financiare dhe huamarrja e ndërmarrjeve në Shqipëri.....</i>	<i>4</i>
<i>1. Organizimi dhe fusha e veprimit.....</i>	<i>4</i>
<i>2. Ecuria financiare e ndërmarrjeve dhe prania e huasë.....</i>	<i>7</i>
<i>3. Karakteristikat e huamarrjes së ndërmarrjeve.....</i>	<i>11</i>
<i>4. Struktura e huasë.....</i>	<i>14</i>
<i>5. Ngarkesa e huasë.....</i>	<i>16</i>
<i>6. Marrëdhënia me bankat dhe pritshmëritë për të ardhmen.....</i>	<i>19</i>

Përmbledhje e gjetjeve kryesore të vrojtimit

Vrojtimi i ndërmarrjeve për gjashtëmujorin e parë 2024 u realizua nëpërmjet një kampioni prej 1,355 ndërmarrjesh të madhësive të ndryshme, të shtrira gjeografikisht në të gjithë vendin dhe që kryejnë aktivitetin e tyre në sektorët kryesorë të ekonomisë. Rezultatet e vrojtimit tregojnë që për shumicën e ndërmarrjeve, ecuria e shitjeve dhe e rezultatit financiar ka qenë pozitive gjatë periudhës, por në përkeqësim krahasuar me periudhën e kaluar. Rritja e kostove të financimit dhe kostove të prodhimit dhe të punës, janë cilësuar si problematikat kryesore të periudhës. Pritjet e ndërmarrjeve për ecurinë e investimeve dhe veprimtarisë vijnë të mbeten optimiste, veçanërisht në rastin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, por disi më të vakëta tek ndërmarrjet e mëdha. Pesha e ndërmarrjeve huamarrëse është rritur gjatë periudhës, por ka mbetur nën nivelin e një viti më parë. Ngarkesa me borxh, në formën e raportit të borxhit ndaj kapitalit dhe në formën e shërbimit të tij ndaj të ardhurave të ndërmarrjes, vlerësohet në rritje për pjesën më të madhe të ndërmarrjeve. Ndërmarrjet presin që kërkesa e tyre për kredi të gjallërohet disi gjatë gjysmës së dytë të vitit 2024.

• GJENDJA FINANCIARE

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2024 (më tej, "periudha"), ndërmarrjet e vogla dhe ato të mesme kanë vlerësuar elementet e "**konkurrencës**" dhe të "**kostot së prodhimit të punës**" si problematikat kryesore në ushtrimin e aktivitetit të tyre, ndërsa ndërmarrjet e mëdha kanë cilësuar "**kostot e financimit**" dhe "**përshtatshmërinë e legjislacionit në fuqi**". Krahasuar me periudhën e kaluar, rëndësia e elementit të "**kostove të financimit**", ka shënuar rritje në rastin e ndërmarrjeve të mëdha dhe atyre të mesme. Për këto të fundit dhe për ndërmarrjet e vogla, si element pengues në rritje është cilësuar dhe "**aksesi në financim**". Këto rezultate reflektojnë efektin e rritjes së përgjithshme të normave të interesit dhe shtrëngimin e kushteve të financimit në vend.

Ecuria e nivelit të shitjeve dhe e rezultatit financiar ka rezultuar përgjithësisht pozitive gjatë periudhës, por në përkeqësim krahasuar me periudhën e kaluar. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme kanë raportuar rënie të rezultatit financiar, ndërsa ndërmarrjet e mëdha kanë raportuar rritje të rezultatit, por në ngadalësim gradual gjatë dy viteve të fundit. Pavarësisht kësaj, mbi 94% e ndërmarrjeve në secilin grup kanë raportuar fitim gjatë periudhës. Pritshmëritë për gjashtëmujorin e ardhshëm për nivelin e shitjeve të përgjithshme dhe rezultatit financiar rezultojnë pozitive, dhe më optimiste krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, por duke mbetur nën vlerat e një viti më parë. **Sinjalet vijnë të jenë optimiste lidhur me zgjerimin e veprimtarisë apo rritjen e investimeve**, veçanërisht tek ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, por paraqesin ngushtim për grupin e ndërmarrjeve të mëdha.

Gjatë periudhës, rreth 57% e ndërmarrjeve kanë vijuar të financojnë veprimtarinë e tyre vetëm nëpërmjet shitjeve (rreth 66% e ndërmarrjeve të vogla, 57% e ndërmarrjeve të mesme dhe 54% e ndërmarrjeve të mëdha), duke shënuar rënie për të tre kategoritë e ndërmarrjeve. Ndërkohë, prirja e kombinimit të burimeve të financimit vijon të zërë një peshë të konsiderueshme për periudhën, duke u rritur krahasuar me periudhën e kaluar, për të tre grupet e ndërmarrjeve.

• HUAMARRJA

Rreth 37% e totalit të ndërmarrjeve që i janë përgjigjur pyetësorit deklarojnë se kanë aktualisht hua për të paguar. Kjo peshë ka shënuar një rritje me 1 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, por rënie me 1 pp krahasuar me një vit më parë. Në terma të madhësisë së ndërmarrjeve, pesha e ndërmarrjeve huamarrëse ka rezultuar në rritje tek ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, por në rënie tek ato të mëdha. Në ndarjen sipas sektorëve, pesha e ndërmarrjeve huamarrëse vijon të jetë më e lartë në sektorin e ndërtimit (46% e totalit të sektorit), ndjekur nga sektori i tregtisë (43% e totalit të sektorit), dhe më e ulët në sektorin e shërbimeve (27%). Me përjashtim të sektorit të tregtisë, të tre sektorët e tjerë rezultojnë të kenë rritje të peshës së ndërmarrjeve huamarrëse krahasuar me periudhën e kaluar.

Në total, burimet formale të huamarrjes (nga banka dhe institucione financiare jobanka) janë përdorur nga 92% e ndërmarrjeve huamarrëse (rreth 84% e ndërmarrjeve të vogla, 93% e ndërmarrjeve të mesme dhe 92% e atyre të mëdha), duke shënuar një rënie të vogël me 0.2 pp krahasuar me gjashtëmujorin e mëparshëm, dhe duke mbetur e pandryshuar krahasuar me një vit më parë. Përdorimi i burimeve formale të financimit ka qenë në rënie tek ndërmarrjet e vogla, i pandryshuar tek ndërmarrjet e mesme dhe disi në rritje tek ato të mëdha. Kombinimi i burimeve formale me ato të formave të tjera është përdorur nga 6% e totalit të ndërmarrjeve.

Huamarrja e ndërmarrjeve është realizuar kryesisht për përballimin e shpenzimeve afatshkurtra dhe për kryerjen e një investimi afatgjatë. Krahasuar me gjashtëmujorin paraardhës, pesha e ndërmarrjeve që kanë marrë hua për të përballuar shpenzimet afatshkurtra është rritur në rastin e ndërmarrjeve të vogla dhe ka rënë në grupin e ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha. Në të njëjtën kohë, pesha e ndërmarrjeve që kanë marrë hua për kryerjen e një investimi afatgjatë ka rezultuar në rënie tek ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, dhe në rritje tek ndërmarrjet e mëdha. Rreth 86% e ndërmarrjeve huamarrëse të vogla, 82% e ndërmarrjeve të mesme dhe 88% e atyre të mëdha, e konsiderojnë të përshtatshëm nivelin e tyre të huamarrjes për financimin e veprimtarisë. Ndërmarrjet e vogla vijojnë të shfaqin kërkesë më të lartë për financim, ndonëse disi në rënie krahasuar me periudhën paraardhëse.

Euroizimi i veprimtarisë së ndërmarrjeve paraqitet përgjithësisht i ulët (rreth 21% e totalit të ndërmarrjeve), por ka shënuar rritje në terma gjashtëmujorë (3pp) dhe vjetorë (4 pp). Në ndarjen sipas madhësisë, ndërmarrjet e mëdha vijojnë të kenë peshën më të lartë të përdorimit të valutës në veprimtarinë e tyre (rreth 34% e ndërmarrjeve), pasuar nga ndërmarrjet e mesme (20% e tyre). Në rastin e ndërmarrjeve të vogla, vetëm 10% e tyre deklarojnë se e kryejnë veprimtarinë në valutë, ndërsa pjesa tjetër operon në lekë (rreth 71% e tyre) ose kombinim i lekut dhe valutës (19% e tyre).

Vlera totale e huasë rezulton afërsisht sa gjysma e vlerës së kapitalit të ndërmarrjes për rreth 81% të ndërmarrjeve huamarrëse, pothuaj e njëjtë me vlerën e kapitalit për 12% të tyre, ndërkohë që pjesa e mbetur prej 7% deklarojnë se kjo vlerë e tejkalon vlerën e kapitalit, duke rezultuar kështu në një raport mesatar hua/kapital prej 78%. Ky raport ka rezultuar në rritje krahasuar me periudhën paraardhëse, veçanërisht në rastin e ndërmarrjeve të mesme, ku rreth 21% e tyre shprehen se huaja është e barabartë ose tejkalon vlerën e kapitalit.

- MARRËDHËNIA ME BANKAT

Vështirësia e procesit të huamarrjes nga bankat vlerësohet midis nivelit “normal” dhe “i vështirë” dhe në rënie gjatë periudhës për të tre grupet e ndërmarrjeve. Marrëdhënia me bankat vijon të vlerësohet midis nivelit “e rëndësishme” dhe “e domosdoshme”. Vlerësimi për këtë element ka shënuar rritje për ndërmarrjet e mëdha, ndërkohë që vlerësohet si pandryshuar për ndërmarrjet e vogla dhe në rënie për ndërmarrjet e mesme.

Lidhur me planifikimin e një huamarrjeje në të ardhmen, rreth 41% e ndërmarrjeve që i janë përgjigjur pyetësorit deklarojnë se “nuk ka asnjë mundësi” që të kërkojnë një kredi bankare gjatë periudhës së ardhshme. Kjo peshë ka rënë për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve në krahasim me periudhën paraardhëse. Nga ana tjetër, vërehet një rritje e peshës së ndërmarrjeve të të gjitha madhësive që pohojnë se “ka pak mundësi” ose “ka shumë mundësi” të kërkojnë një kredi në gjysmën e dytë të vitit 2024. Si rezultat, *indeksi i planifikimit të huamarrjes* ka shënuar një rritje të lehtë krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, dhe krahasuar me një vit më parë, e ardhur nga të tre grupet e ndërmarrjeve, por më e theksuar në rastin e ndërmarrjeve të mesme.

Gjendja financiare dhe huamarrja e ndërmarrjeve në Shqipëri

Karakteristikat e kampionit të vrojtuar¹. Në gjashtëmujorin e parë 2024 (më tej “periudha”), vrojtimi u realizua mbi një kampion prej 1355 ndërmarrjesh, të shpërndara në 12 qarqet e vendit. Pjesa kryesore e këtyre ndërmarrjeve (rreth 84%), janë përqendruar kryesisht në 5 qarqe, përkatësisht në: Tiranë (rreth 53%), Durrës (rreth 16%), Fier (rreth 7%), Shkodër (rreth 5%) dhe Vlorë (rreth 4%).


Në totalin e kampionit të përzgjedhur, rreth 85% e ndërmarrjeve (gjithsej 1145 ndërmarrje) i janë përgjigjur plotësisht ose pjesërisht pyetjeve të vrojtimit dhe analiza e rezultateve mbështetet në këto përgjigje.

1. Organizimi dhe fusha e veprimit


1.1 Shpërndarja sektoriale dhe madhësia e ndërmarrjeve

Për periudhën, në ndarjen sipas sektorëve, rreth 38% e ndërmarrjeve i përkasin sektorit të *industrisë*, rreth 29% sektorit të *shërbimeve*, rreth 15% sektorit të *ndërtimit* dhe rreth 19% sektorit të *tregtisë*.

Grafik 1.1 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas sektorëve



Grafik 1.2 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas madhësisë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sipas madhësisë, rreth 22% e ndërmarrjeve klasifikohen si *ndërmarrje të vogla* (5-19 persona të punësuar), rreth 18% si *ndërmarrje të mesme* (20-49 të punësuar) dhe rreth 60% si *ndërmarrje të mëdha* (mbi 50 të punësuar). Në grupin e *ndërmarrjeve të vogla*, peshën kryesore e zënë ndërmarrjet që operojnë në *sektorin e shërbimeve* (rreth 35%, pothuaj në një nivel me gjashtë muaj më parë, por në rënie me 5 pp krahasuar me vitin e kaluar), ndjekur nga *sektori i industrisë* (rreth 29%, pothuaj e pandryshuar në terma gjashtëmujorë, por në rritje me 7 pp në terma vjetorë). Nga ana tjetër, në grupin e ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha, peshën më të lartë e kanë ndërmarrjet e sektorit të industrisë (përkatësisht prej rreth 39% dhe 41%, të dyja në rënie në terma gjashtëmujorë, por në rritje në terma vjetorë) dhe ato të sektorit të shërbimeve (me peshë

¹ Vrojtimi i gjendjes financiare dhe huamarrjes së ndërmarrjeve kryhet që prej gjashtëmujorit të dytë 2010, me një frekuencë gjashtëmujore. Fillimisht, ky vrojtimit u hodh në terren me një kampion të përzgjedhur prej 700 ndërmarrjesh me shitje neto vjetore më të lartë (ndërmarrje të mëdha). Më tej, në vitin 2016, kampioni u zgjerua në rreth 1200 ndërmarrje të mëdha, të mesme e të vogla, të shtrira gjeografikisht në të gjithë vendin.


përkatësisht 26% dhe 27%, në rritje referuar një gjashtëmujori më parë, por në rënie krahasuar me një vit më parë).

1.2 Sigurimi i lëndës së parë dhe shitja e produkteve


Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve të vogla dhe një pjesë e mirë e atyre të mesme (rreth 61% e ndërmarrjeve të vogla dhe 36% e atyre të mesme) e sigurojnë mbi 80% të lëndës së parë brenda vendit. Krahasuar me periudhën paraardhëse, ky tregues ka shënuar rritje me 1 pp për ndërmarrjet e vogla dhe 3 pp për ato të mesme. E njëjta prirje është vënë re dhe tek ndërmarrjet e mëdha, ku rreth 33% e tyre kanë deklaruar se sigurojnë mbi 80% të lëndës së parë brenda vendit (rritur me 2 pp në terma gjashtëmujorë dhe me 3 pp në terma vjetorë), ndërkohë që rreth 39% e ndërmarrjeve të këtij grupi, sigurojnë vetëm 20% të lëndës së parë brenda vendit.

Shitja e produkteve vijon të mbetet kryesisht brenda vendit, ku rreth 88% e ndërmarrjeve të vogla, 69% e ndërmarrjeve të mesme dhe 56% e ndërmarrjeve të mëdha, kanë deklaruar se kanë shitur shumicën e produkteve në tregun vendas (mbi 80% të volumit të produkteve). Krahasuar me gjashtëmujorin e mëparshëm, ka pasur një rritje prej 4.6 pp të peshës së ndërmarrjeve të mesme që i shesin produktet e tyre kryesisht brenda vendit, ndërkohë që për ndërmarrjet e vogla dhe të mëdha, këto pesha kanë mbetur pothuaj të njëjta.

Grafik 1.3 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas peshës së blerjes së lëndës së parë brenda vendit



Grafik 1.4 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas peshës së shitjeve brenda vendit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Nga analiza e përgjigjeve sipas sektorëve, rezulton se sektori i ndërtimit dhe ai i shërbimeve janë sektorët me varësinë më të madhe ndaj lëndës së parë të siguruar në vend, ku respektivisht 70% dhe 58% e ndërmarrjeve të këtyre sektorëve, siguron mbi 80% të lëndës së parë brenda vendit. Gjatë periudhës së vrojtuar, kjo peshë ka rezultuar në rritje me 3 pp në rastin e sektorit të ndërtimit, dhe në rënie me 6 pp në rastin e sektorit të shërbimeve, ndërsa krahasuar me një vit më parë, të dy këto pesha kanë qenë në rritje respektivisht me 13 pp dhe 7 pp. Nga ana tjetër, sektori i industrisë shfaq varësinë më të ulët, ku vetëm 23% e ndërmarrjeve sigurojnë shumicën e lëndës së parë brenda vendit, ndërsa 52% sigurojnë vetëm 20% të lëndës së parë brenda vendit.

Tabelë 1.1 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas sektorëve dhe përqindjes së blerjes së lëndës së parë brenda vendit

		Deri në 20%	20-50%	50-80%	Mbi 80%
Industri	6MI 2021	53.6%	14.1%	9.1%	24.2%
	6MII 2021	49.1%	16.1%	12.7%	22.1%
	6MI 2022	49.2%	14.1%	14.3%	22.4%
	6MII 2022	52.0%	14.0%	13.3%	20.7%
	6MI 2023	52.4%	15.8%	12.2%	19.6%
	6M II 2023	56.0%	15.1%	8.0%	20.9%
	6MI 2024	52.2%	13.0%	12.1%	22.7%
Shërbime	6MI 2021	18.4%	6.4%	14.3%	60.8%
	6MII 2021	18.5%	4.2%	11.2%	66.1%
	6MI 2022	17.8%	7.9%	13.5%	60.8%
	6MII 2022	21.8%	8.6%	12.9%	56.7%
	6MI 2023	23.6%	9.5%	16.1%	50.7%
	6MII 2023	18.5%	6.9%	13.2%	63.7%
	6MI 2024	20.2%	8.6%	13.8%	57.5%
Ndërtim	6MI 2021	4.4%	3.1%	20.1%	72.3%
	6MII 2021	1.2%	5.3%	17.5%	76.0%
	6MI 2022	2.3%	5.2%	23.3%	69.2%
	6MII 2022	4.8%	9.7%	23.0%	62.4%
	6MI 2023	5.6%	11.1%	25.9%	57.4%
	6MII 2023	6.1%	6.7%	20.2%	66.9%
	6MI 2024	4.2%	5.4%	20.4%	70.1%
Tregti	6MI 2021	29.7%	24.7%	16.4%	29.2%
	6MII 2021	41.2%	17.1%	15.6%	26.1%
	6MI 2022	36.8%	23.2%	11.6%	28.4%
	6MII 2022	37.6%	26.1%	15.9%	20.4%
	6MI 2023	32.9%	23.8%	18.2%	25.1%
	6MII 2023	34.7%	29.2%	18.5%	18.1%
	6MI 2024	38.1%	17.7%	19.5%	24.7%


Burimi: Banka e Shqipërisë.

1.3 Elementet kufizuese në aktivitetin e ndërmarrjeve²

Gjatë periudhës, ndërmarrjet e vogla dhe ato të mesme kanë vlerësuar elementet e **“konkurrencës”** dhe të **“kostos së prodhimit të punës”** si problematikat kryesore në ushtrimin e aktivitetit të tyre, ndërsa ndërmarrjet e mëdha kanë cilësuar **“kostot e financimit”** dhe **“përshtatshmërinë e legjislacionit në fuqi”**. Rëndësia e elementit të **“kostove të financimit”**, ka shënuar rritje në krahasim me periudhën e mëparshme në rastin e ndërmarrjeve të mëdha dhe atyre të mesme, ndërkohë që për këto të fundit dhe për ndërmarrjet e vogla, si element pengues në rritje është cilësuar dhe **“aksesi në financim”**. Këto rezultate kanë reflektuar rritjen e përgjithshme të normave të interesit dhe shtrëngimin e kushteve të financimit në vend.

² Ndërmarrjet kanë vlerësuar rëndësinë e disa problemeve të caktuara sipas një shkalle nga 1 deri në 10, ku 1 është shkalla më e ulët dhe 10 është shkalla më e lartë e vështirësisë. Për të agreguar përgjigjet për secilën çështje të vlerësuar, është llogaritur një mesatare e peshuar për të gjitha ndërmarrjet e përgjigjura, duke peshuar përgjigjet e tyre me shkallët e vlerësimit (1-10).

Grafik 1.5 Vlerësimi i ndikimit të disa faktorëve në veprimtarinë e ndërmarrjes



Burimi: Banka e Shqipërisë.


2. Ecuria financiare e ndërmarrjeve dhe prania e huasë

2.1 Monedha e kryerjes së veprimtarisë

Euroizimi i veprimtarisë së ndërmarrjeve paraqitet përgjithësisht i ulët, por ka shënuar rritje në terma gjashtëmujorë dhe vjetorë. Rreth 21% e totalit të ndërmarrjeve deklarojnë se kryejnë veprimtarinë plotësisht ose kryesisht në valutë³, duke shënuar rritje me 3 pp dhe 4 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe me një vit më parë. Në ndarjen sipas madhësisë, ndërmarrjet e mëdha vijojnë të kenë peshën më të lartë të përdorimit të valutës në veprimtarinë e tyre (rreth 34% e ndërmarrjeve), pasuar nga ndërmarrjet e mesme (20% e ndërmarrjeve). Në rastin e ndërmarrjeve të vogla, vetëm 10% e tyre deklarojnë se e kryejnë veprimtarinë në valutë. Krahasuar me periudhën e kaluar, këto pesha kanë shënuar rritje në rastin e ndërmarrjeve të mesme dhe kanë qenë në rënie në rastin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mëdha.

³ Mbi 50% të veprimtarisë në valutë.

Grafik 2.1 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas madhësisë dhe monedhës së kryerjes së veprimtarisë




Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.2 Ecuria e shitjeve, rezultati financiar dhe zgjerimi i veprimtarisë

Gjatë periudhës, niveli i përgjithshëm i shitjeve për totalin e ndërmarrjeve ka qenë pozitiv, por në përkeqësim krahasuar me gjashtë muaj më parë. Të tre grupet e ndërmarrjeve kanë raportuar nivel pozitiv të shitjeve (me balanca neto pozitive, përkatësisht 2.0%, 3.3% dhe 16.8%), por në ngadalësim krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe me një vit më parë. Për sa i përket ecurisë së nivelit të shitjeve në 6 muajt e ardhshëm, pritshmëritë për të tre grupet e ndërmarrjeve rezultojnë pozitive dhe më optimiste krahasuar me periudhën e kaluar, por duke mbetur nën vlerat e një viti më parë.


Grafik 2.2 Balanca neto e shitjeve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Balancat neto të përgjigjeve janë llogaritur si diferencë midis peshave të përgjigjeve pozitive (rritje e shitjeve/rritje e pritshmërive të shitjeve) dhe përgjigjeve negative (rënie e shitjeve/rënie e pritshmërive mbi shitjet) ndaj totalit të përgjigjeve të dhëna.

Grafik 2.3 Balanca neto e pritshmërive të shitjeve




Ecuria e agreguar e nivelit të shitjeve të përgjithshme është analizuar nëpërmjet një indeksi⁴, i cili peshon përgjigjet e ndërmarrjeve sipas intervaleve të ndryshme dhe i grupon ato sipas madhësisë së ndërmarrjeve dhe sipas sektorëve. Ecuria e indeksit të shitjeve ka rezultuar në rënie gjatë periudhës për totalin e ndërmarrjeve, e ardhur kryesisht nga grupi i ndërmarrjeve të vogla dhe atyre të mëdha, ndërkohë që për

⁴ Koeficientët e peshimit sipas intervaleve të shitjeve të përgjithshme janë: "Deri në 10 milionë lekë" = 0; "10-49 milionë lekë" = 0.25; "50-99 milionë lekë" = 0.5; "100-500 milionë lekë" = 0.75; "Mbi 500 milionë lekë" = 1. Rritja/ulja e vlerës së këtij indeksi nënkupton një rritje/ulje të nivelit të shitjeve të përgjithshme të ndërmarrjeve.


ndërmarrjet e mesme, indeksi ka shënuar rritje. Në rang sektorial, indeksi ka rezultuar në rritje për ndërmarrjet e sektorit të ndërtimit, duke tejkaluar vlerat e gjashtëmujorit të kaluar dhe të një viti më parë. Indeksi ka shënuar rritje graduale dhe për sektorin e shërbimeve, ndërkohë që ka qenë në rënie në sektorin e industrisë dhe të tregtisë.

Grafik 2.4 Indeksi i përgjithshëm i shitjeve sipas madhësisë së ndërmarrjeve




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 2.5 Indeksi i shitjeve të përgjithshme sipas sektorëve




Në linjë me ecurinë e shitjeve, ndërmarrjet kanë raportuar rezultat financiar pozitiv gjatë periudhës, por në rënie krahasuar me periudhat e kaluara. Kështu, ndërmarrjet e vogla dhe ato të mesme kanë raportuar rënie të rezultatit financiar, më e theksuar në rastin e ndërmarrjeve të vogla (me balanca neto respektivisht -2.8% dhe -1.6%). Ndërmarrjet e mëdha kanë raportuar rritje të rezultatit financiar gjatë periudhës (balancë neto 12.8%), por në rënie graduale gjatë dy viteve të fundit. Sikurse në rastin e pritshmërive të shitjeve, *pritsmëritë për rezultatin financiar në gjashtëmujorin e ardhshëm paraqiten pozitive* dhe më optimiste krahasuar me periudhën e kaluar, por duke mbetur nën vlerat e rezultuara një vit më parë.

Grafik 2.6 Balanca neto e rezultatit financiar



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Grafik 2.7 Balanca neto e rezultatit financiar të pritshëm në gjashtëmujorin e ardhshëm



Balancat neto të përgjigjeve janë llogaritur si diferencë midis peshave të përgjigjeve pozitive (rritje e rezultatit financiar/rritje e pritshmërive) dhe përgjigjeve negative (rënie e rezultatit financiar/rënie e pritshmërive) ndaj totalit të përgjigjeve të dhëna.

Për ndërmarrjet e përgjigjura lidhur me rezultatin financiar⁵ në gjashtëmujorin e parë 2024, mbi 94% e secilit grup sipas madhësisë kanë raportuar fitim gjatë periudhës. Kjo peshë ka rezultuar më e lartë për ndërmarrjet e mesme (rreth 98%), ndërkohë që në dy grupet e tjera ka rezultuar rreth 95%. Krahasuar me periudhën paraardhëse, pesha e ndërmarrjeve që kanë raportuar fitim është rritur për ndërmarrjet e mesme (me 3.5 pp) dhe të vogla (me 0.4 pp), dhe ka rënë në rastin e ndërmarrjeve të mëdha (me 1.5 pp).


Grafik 2.8 Rezultati financiar sipas madhësisë së ndërmarrjeve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Vlerësimi i ndërmarrjeve për rritjen e investimeve dhe zgjerimin e veprimtarisë vijon të japë sinjale pozitive për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve. Ndërmarrjet e vogla dhe mesme kanë raportuar në agregat zgjerim të veprimtarisë gjatë periudhës (balanca neto pozitive prej 6% dhe 10%), dhe në rritje krahasuar me periudhën e mëparshme. Ndërkohë, edhe ndërmarrjet e mëdha kanë pohuar zgjerim të veprimtarisë, me një balancë pozitive prej 18.7%, por në ngushtim krahasuar me periudhën e kaluar dhe krahasuar me një vit më parë. Për gjashtëmujorin e ardhshëm, balancat neto të përgjigjeve kanë rezultuar pozitive për të gjitha madhësitë e ndërmarrjeve, duke nënkuptuar pritshmëri për investim apo zgjerim të mëtejshëm të veprimtarisë. Krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, këto pritshmëri paraqiten më optimiste në grupin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, dhe më të dobëta për ndërmarrjet e mëdha.


Grafik 2.9 Balanca neto e zgjerimit të veprimtarisë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Balancat neto të përgjigjeve janë llogaritur si diferencë midis peshave të përgjigjeve pozitive (zgjerim i veprimtarisë/pritshmëri për zgjerim apo investim) dhe përgjigjeve negative (ngushtim i veprimtarisë/pritshmëri për ngushtim) ndaj totalit të përgjigjeve të dhëna.

Grafik 2.10 Balanca neto e zgjerimit të veprimtarisë në gjashtëmujorin e ardhshëm




⁵ Janë përgjigjur 1064 ndërmarrje ose rreth 79% e kampionit.

2.3 Financimi i veprimtarisë

Gjatë periudhës, rreth 57% e ndërmarrjeve kanë vijuar të financojnë veprimtarinë e tyre vetëm nëpërmjet shitjeve (rreth 66% e ndërmarrjeve të vogla, 57% e ndërmarrjeve të mesme dhe 54% e ndërmarrjeve të mëdha), **duke shënuar rënie për të tre kategoritë e ndërmarrjeve**. Ndërkohë, prirja e kombinimit të burimeve të financimit vijon të zërë një peshë të konsiderueshme për periudhën, duke u rritur krahasuar me periudhën e kaluar, për të tre grupet e ndërmarrjeve. Peshën kryesore të tyre vijon ta ketë financimi i realizuar nëpërmjet kombinimit të shitjeve me rezervat e mbartura, ndjekur nga kombinimi i shitjeve me huanë.

Grafik 2.11 Financimi i veprimtarisë sipas madhësisë së ndërmarrjeve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

3. Karakteristikat e huamarrjes së ndërmarrjeve

Rreth 37% e totalit të ndërmarrjeve që janë përgjigjur⁶ (gjithsej 425 ndërmarrje), pohojnë se kanë aktualisht një hua për të paguar. Kjo peshë ka shënuar një rritje prej 1 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, por rënie me 1 pp krahasuar me një vit më parë, gjë që është e pritshme në kushtet e kostove ende të larta të huamarrjes nga bankat në vend.

Tabelë 3.1 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas madhësisë dhe huamarrjes

Ndërmarrjet huamarrëse sipas madhësisë	Nr. i ndërmarrjeve		Pesha ndaj totalit të grupit	
	6M II 2023	6M I 2024	6M II 2023	6M I 2024
Të vogla	63	70	24%	28%
Të mesme	63	68	33%	32%
Të mëdha	284	287	41%	42%
Total ndërmarrje	410	425	36%	37%

Burimi: Banka e Shqipërisë.

⁶ Duke marrë në konsideratë kampionin e plotë prej 1355 ndërmarrjesh, 1146 prej tyre ose rreth 85% kanë dhënë përgjigje.

Në terma të madhësisë së ndërmarrjeve, rritja e peshës së ndërmarrjeve huamarrëse ka ardhur kryesisht nga grupi i ndërmarrjeve të vogla dhe atyre të mëdha, ndërkohë që huamarrja tek ndërmarrjet e mesme ka rezultuar në rënie gjatë periudhës. Në ndarjen sipas sektorëve, sektori i ndërtimit vijon të ketë peshën më të lartë të ndërmarrjeve huamarrëse (46% e ndërmarrjeve të sektorit), ndërsa sektori i shërbimeve peshën më të ulët (27% e ndërmarrjeve). Me përjashtim të sektorit të tregtisë, të tre sektorët e tjerë rezultojnë të kenë rritje të peshës së ndërmarrjeve huamarrëse krahasuar me periudhën e kaluar.

Tabelë 3.2 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas sektorëve dhe huamarrjes

Ndërmarrjet huamarrëse sipas madhësisë	Nr. i ndërmarrjeve		Pesha ndaj totalit të grupit	
	6MII 2023	6MI 2024	6MII 2023	6MI 2024
Industri	168	168	37%	38%
Shërbime	75	88	24%	27%
Ndërtim	73	76	45%	46%
Tregti	94	93	43%	43%


Burimi: Banka e Shqipërisë.

Analiza e mëposhtme është realizuar duke u mbështetur vetëm në përgjigjet e ndërmarrjeve huamarrëse.

3.1 Burimi i huasë

Rreth 91% e ndërmarrjeve huamarrëse deklarojnë se i janë drejtuar sistemit financiar si burim i vetëm i huamarrjes (90% nga sektori bankar dhe 1% nga sektori financiar jobankar), 4% kanë përdorur burime joformale (si persona fizikë, kompani të tjera, mall i papaguar etj.), ndërsa thuajse 5% e tyre kanë përdorur një kombinim burimesh formale dhe joformale. Pesha e ndërmarrjeve që deklarojnë vetëm hua formale ka rënë me 0.2 pp krahasuar me gjatshëmujorin e kaluar, dhe ka mbetur e pandryshuar krahasuar me një vit më parë.

Grafik 3.1 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas burimit të huasë




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Të ndara sipas madhësisë, rezulton se rreth 81% e ndërmarrjeve të vogla, 91% e atyre të mesme, i janë drejtuar *vetëm bankave si burim huamarrjeje*, dhe këto pesha kanë rënë (respektivisht me 3 pp dhe 2 pp) krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar. Gjithashtu, 91% e ndërmarrjeve të mëdha e kanë siguruar huanë vetëm përmes bankave dhe kjo peshë ka shënuar rritje me 1 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe e pandryshuar me një vit më parë. Përveç bankave, një pjesë e vogël e ndërmarrjeve i janë drejtuar edhe institucioneve financiare jobanka (vetëm 3% e ndërmarrjeve të vogla, 1% e ndërmarrjeve të mesme dhe 0.3% e ndërmarrjeve të mëdha) ose kanë kombinuar burimet formale me burime të tjera (si hua nga persona fizikë, kompani të tjera, mall i papaguar). Në total, *huaja formale* është përdorur nga 84% e ndërmarrjeve të vogla (rënie me 5 pp krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar), 93% e ndërmarrjeve të mesme (e pandryshuar) dhe në 92% e ndërmarrjeve të mëdha (ritje me 1 pp).

3.2 Qëllimi i huasë

Huamarrja e ndërmarrjeve është realizuar kryesisht për përballimin e shpenzimeve afatshkurtra dhe për kryerjen e një investimi afatgjatë. Krahasuar me gjashtëmujorin paraardhës, pesha e ndërmarrjeve që kanë marrë hua për të përballuar shpenzimet afatshkurtra është rritur në rastin e ndërmarrjeve të vogla (me 8 pp) dhe ka rënë në rastin e ndërmarrjeve të mesme (me 24 pp) dhe atyre të mëdha (me 4 pp). Në të njëjtën kohë, pesha e ndërmarrjeve të cilat kanë marrë hua për kryerjen e një investimi afatgjatë ka rënë në grupin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mëdha (respektivisht me 13 pp dhe 2pp), ndërkohë që ka shënuar rritje në grupin e ndërmarrjeve të mesme (me 5 pp). Një peshë të rëndësishme vijon të ketë marrja e huasë për më shumë se një qëllim, ku dominon kombinimi i dy qëllimeve të mësipërme, si dhe kombinimi për përballimin e shpenzimeve afatshkurtra dhe shlyerjen e një huajë më të vjetër.

Grafik 3.2 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas qëllimit të përdorimit të huasë




Burimi: Banka e Shqipërisë.

3.3 Mjaftueshmëria e huasë

Gjatë periudhës, rreth 87% e ndërmarrjeve e konsiderojnë të përshtatshëm nivelin e huamarrjes për financimin e veprimtarisë së tyre dhe kjo peshë ka mbetur e njëjtë me periudhën e kaluar. Në ndarjen sipas madhësisë së ndërmarrjeve, ky tregues rezulton 86% në rastin e ndërmarrjeve të vogla, 82% për ndërmarrjet e mesme dhe 88% për ndërmarrjet e mëdha. Krahasuar me periudhën e kaluar, kjo peshë është rritur në rastin e ndërmarrjeve të vogla, dhe ka rezultuar në rënie në grupet e ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha. Pjesa tjetër e përgjigjeve ka rezultuar në balanca neto pozitive në rastin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mëdha, gjë që tregon se pesha e ndërmarrjeve që do të preferonin më shumë hua për financimin e

veprimtarisë e tejkalon peshën e atyre që *do të preferonin më pak*, por negative në rastin e atyre të mesme. Sikurse në vrotimin e kaluar, ndërmarrjet e vogla vijnë të shfaqin kërkesë më të lartë për financim, ndonëse disi në rënie krahasuar me periudhën paraardhëse.

Grafik 3.3 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas mjaftueshmërisë së huasë



Burimi: Banka e Shqipërisë.


4. Struktura e huasë

4.1 Monedha

Sipas monedhës, huamarrja në lekë vijon të ketë peshën kryesore në huamarrjen e ndërmarrjeve.

Kështu, në 47% të rasteve, ndërmarrjet kanë deklaruar se huamarrja e tyre është në lekë, në 43% të rasteve në valutë (euro dhe/ose dollarë amerikanë) dhe në 10% të rasteve huamarrja është e kombinuar (lekë dhe valutë). Huamarrja në monedhën vendase është më e zakonshme tek ndërmarrjet e vogla dhe të mesme ku respektivisht 56% dhe 48% e tyre kanë deklaruar se kanë vetëm hua në lekë. Këto pesha kanë shënuar rënie (me 5 pp dhe 9 pp) krahasuar me periudhën e kaluar, ndërkohë që është rritur pesha brenda grupit e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme që deklarojnë hua në valutë ose kombinim monedhash.

Grafik 4.1 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas monedhës së huasë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

4.2 Marrja e huasë dhe afati i maturimit

Në 1-5 vitet e fundit, kanë marrë hua përkatësisht rreth 63% e ndërmarrjeve të vogla, 54% e ndërmarrjeve të mesme dhe 56% e ndërmarrjeve të mëdha. Krahasuar me një gjashtëmujor më parë, këto pësha kanë shënuar rritje (me 5 pp) në rastin e ndërmarrjeve të vogla, kanë rënë (respektivisht me 3 pp dhe 4 pp) në rastin e ndërmarrjeve të mesme dhe atyre të mëdha.

Huamarrja e re, e cila nënkupton huamarrjen në gjashtëmujorin e fundit, deklarohet nga rreth 11% e ndërmarrjeve të vogla, 4% e ndërmarrjeve të mesme dhe 10% e ndërmarrjeve të mëdha. Në terma gjashtëmujorë, pësha e huamarrësve të rinj ka rezultuar në rritje vetëm tek ndërmarrjet e vogla, por në rënie në dy grupet e tjera. Në terma vjetorë, pësha e huamarrësve të rinj ka qenë në rritje në të tre grupet e ndërmarrjeve. *Qëllimi kryesor i përdorimit të huamarrjes së re ka qenë përballimi i shpenzimeve afatshkurtra të periudhës* (për rreth 39% të totalit të ndërmarrjeve të përgjigjura), *kryerja e një investimi afatgjatë* (rreth 21% e totalit) dhe *kombinimi i disa qëllimeve* (për rreth 34% të totalit). Krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, ka një rritje të peshës së ndërmarrjeve të vogla që kanë marrë hua të re për të përballuar shpenzimet afatshkurtra (me 75 pp), ndërkohë që për ndërmarrjet e vogla dhe ato të mëdha, kjo peshë ka rezultuar në rënie (respektivisht me 75pp dhe 4 pp). Në të njëjtën kohë, pësha e huamarrësve të rinj me qëllim kryerjen e një investimi afatgjatë ka rezultuar në rritje krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, vetëm në grupin e ndërmarrjeve të mesme dhe atyre të mëdha, ndërkohë që asnjë ndërmarrje e vogël nuk deklaroi huamarrje për këtë qëllim. Afati i mbetur deri në maturim i huamarrjes ka rezultuar mesatarisht 37.5 muaj për ndërmarrjet e vogla, 42.3 muaj për ndërmarrjet e mesme dhe 37.7 muaj për ndërmarrjet e mëdha. Në të tri rastet, afati i mbetur deri në maturim ka rezultuar në rënie si krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe krahasuar me një vit më parë.

4.3 Norma e interesit të huasë dhe mënyra e shlyerjes

Lloji kryesor i normës së interesit të huasë (ose më të madhe ekzistuese⁷) mbetet norma e pandryshueshme deri në fund të afatit (për rreth 66% të ndërmarrjeve të vogla, 59% e atyre të mesme dhe 62% e ndërmarrjeve të mëdha) dhe **norma e ndryshueshme çdo vit** (për 20% të ndërmarrjeve të vogla, 28% të atyre të mesme dhe 27% të ndërmarrjeve të mëdha). Në krahasim me periudhën paraardhëse, pësha e ndërmarrjeve që raportojnë hua me normë të ndryshueshme çdo vit ka rezultuar në rritje për ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha dhe në rënie për ndërmarrjet e vogla. Frekuenca e shlyerjes vijon të mbetet kryesisht mujore, për 81% të ndërmarrjeve huamarrëse të vogla, 79% të ndërmarrjeve të mesme dhe për 82% të ndërmarrjeve të mëdha.

4.4 Forma e kolateralit dhe raporti i mbulimit


Rreth 60% e ndërmarrjeve të vogla, 75% e ndërmarrjeve të mesme dhe 80% e atyre të mëdha, deklarojnë se huaja e marrë është e kolateralizuar vetëm me pasuri të paluajtshme, ndërsa pjesa tjetër e ndërmarrjeve ka përdorur forma të tjera kolateralizimi⁸. Ndërkohë, rreth 26% e ndërmarrjeve të vogla, 12% e ndërmarrjeve të mesme dhe 7% e ndërmarrjeve të mëdha, pohojnë se huaja e marrë është e pakolateralizuar. Krahasuar me periudhën e kaluar, kjo peshë kanë rënë respektivisht me 2 pp në rastin e ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha dhe ka mbetur e pandryshuar në rastin e ndërmarrjeve të vogla. Gjithashtu kolateralizimi me mjete financiare ka qenë në rënie në grupet e ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha, ndërsa kolateralizimi me dorëzani/garanci, në rritje tek ndërmarrjet e vogla.

⁷ Në rastin e ndërmarrjeve, të cilat kanë më shumë se një hua.

⁸ Mjete financiare, dorëzani, garanci të tjera, së bashku me kombinimin e disa formave të kolateralizimit, përfshirë edhe kombinimin me pasuri të paluajtshme.


Mbulimi me kolateral vlerësohet edhe në mënyrë të agreguar përmes indeksit të peshuar të përgjigjeve⁹. Për gjashtëmujorin e parë 2024, ky indeks për totalin e ndërmarrjeve ka rezultuar 0.56 (0.50 për ndërmarrjet e vogla, 0.57 për ndërmarrjet e mesme dhe 0.57 për ato të mëdha), duke shënuar rritje krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar dhe krahasuar me një vit më parë, e ardhur nga të tre grupet e ndërmarrjeve.

Grafik 4.2 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas formës së kolateralit të huasë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 4.3 Indeksi i mbulimit me kolateral




5. Ngarkesa e huasë

5.1 Vlera e huasë ndaj kapitalit

Raporti "Hua/kapital" ka shënuar rritje për totalin e ndërmarrjeve të vrojtuar krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar. Rreth 81% e ndërmarrjeve raportojnë se vlera totale e huasë rezulton afërsisht sa gjysma e kapitalit të ndërmarrjes, 12% deklarojnë se është pothuaj e njëjtë me vlerën e kapitalit dhe prej 7% deklarojnë që kjo vlerë e tejkalon atë të kapitalit, duke rezultuar kështu në një raport mesatar hua/kapital prej 78%. Gjatë periudhës, ky raport ka rezultuar në rritje krahasuar me periudhën paraardhëse, veçanërisht në rastin e ndërmarrjeve të mesme, ku rreth 21% e tyre shprehen se huaja është e barabartë ose tejkalon vlerën e kapitalit.

Grafik 5.1 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas madhësisë dhe raportit hua/kapital



Burimi: Banka e Shqipërisë.

⁹ Ky indeks merr vlera nga 0 në 1 dhe rritja e vlerës së tij tregon rritje të peshës së mbulimit me kolateral. Koefficientët e peshimit të këtij indeksi, sipas alternativave, janë: "deri në 50% të vlerës së huasë së kolateralizuar" = 0.25; "50-100% të vlerës së huasë së kolateralizuar" = 0.5; "100-120% të vlerës së huasë së kolateralizuar" = 0.75; "mbi 120% të huasë së kolateralizuar" = 1.

Në nivel sektorial, raporti hua/kapital ka shënuar rritje për të gjitha degët e ekonomisë ku operojnë ndërmarrjet, me përjashtim të sektorit të "shërbimeve", që ka mbetur i pandryshuar nga periudha e kaluar. Nga ana tjetër, ky sektor rezulton me vlerën më të lartë të huasë ndaj kapitalit, ku rreth 22% e ndërmarrjeve kanë deklaruar se kjo vlerë është e barabartë ose tejkalon vlerën e kapitalit.

Tabelë 5.1 Pesha e ndërmarrjeve me një vlerë huaje të barabartë ose më të lartë se kapitali, sipas sektorëve


Pesha e ndërmarrjeve me një vlerë huaje të barabartë ose më të lartë se kapitali, sipas sektorëve				
	Industri	Shërbime	Ndërtim	Tregti
6MII 2022	22%	29%	26%	25%
6MI 2023	10%	20%	24%	18%
6MII 2023	15%	15%	18%	15%
6MI 2024	20%	22%	18%	18%

Burimi: Banka e Shqipërisë.

5.2 Shpenzimi për pagesën e huasë


Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve (rreth 77%) deklarojnë se pagesa e huasë arrin "deri në 20% të të ardhurave" të tyre, dhe kjo peshë nuk ka ndryshuar krahasuar me vrojtimin paraardhës. Barra e pagesës ka rezultuar më e lartë tek ndërmarrjet e vogla dhe ato të mëdha, ku respektivisht 27% dhe 24% e tyre raportojnë se kjo pagesë i tejkalon 20% të të ardhurave dhe këto pesha janë rritur gjatë periudhës.

Grafik 5.2 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas raportit të pagesës së huasë ndaj të ardhurave



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 5.3 Ndërmarrjet që deklarojnë ndryshim të pagesës së huasë gjatë periudhës




Të pyetura nëse kostoja e shërbimit ka ndryshuar gjatë periudhës, shumica e ndërmarrjeve (rreth 81%) raportojnë se pagesa e huasë ka mbetur e pandryshuar, por kjo peshë ka rënë krahasuar me periudhën e kaluar. Përgjigjet e pjesës tjetër rezultojnë në balancë neto pozitive dhe në rritje, gjë që tregon për rritje të këtij shpenzimi gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti. Ky rezultat është konstatuar tek të tre grupet e ndërmarrjeve, por më i theksuar në rastin e ndërmarrjeve të vogla dhe atyre të mesme.


5.3 Ngarkesa me borxh dhe përballimi i kostos së huasë

Për të kompensuar rritjen e kostos së shërbimit të huasë, ndërmarrjet gjatë periudhës janë mbështetur kryesisht në rritjen e çmimit të produkteve që u shiten klientëve (39% e rasteve) dhe uljen e shpenzimeve (në 34% të rasteve) dhe në përdorimin e rezervave të ndryshme (në 11% të rasteve). Ngarkesa me borxh e ndërmarrjeve huamarrëse është rritur gjatë periudhës, ku vlera e indeksit për totalin e ndërmarrjeve ka shënuar një nivel prej 0.64. Sipas madhësisë, indeksi paraqet një ngarkesë më të lartë me borxh në rastin e ndërmarrjeve të mesme (vlerë indeksi 0.68), të cilat kanë shënuar dhe rritjen më të lartë krahasuar me periudhën e kaluar.

Grafik 5.4 Mënyrat e përballimit të kostos së huasë



Grafik 5.5 Indeksi i ngarkesës me borxh të ndërmarrjeve




Burimi: Banka e Shqipërisë.

5.5 Pritshmëritë për pagesën e këstit të huasë për gjashtëmuajorin e ardhshëm

Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve huamarrëse (rreth 82%), pavarësisht madhësisë, nuk presin ndryshim të kostos së huasë në gjysmën e dytë të vitit 2024. Kjo peshë ka rënë me 3 pp krahasuar me periudhën paraardhëse dhe me 4 pp krahasuar me një vit më parë. Për sa i përket ndërmarrjeve që presin ndryshim të këstit, rezulton se pjesa më e madhe e tyre presin rritje të mëtejshme (balancë neto pozitive prej 11.8%). Pritshmëritë për rritje kanë rezultuar më të larta tek ndërmarrjet e mëdha dhe ato të mesme.

Grafik 5.6 Pritshmëritë mbi ndryshimin e këstit të huasë në gjashtëmuajorin e ardhshëm



Burimi: Banka e Shqipërisë.


6. Marrëdhënia me bankat dhe pritshmëritë për të ardhmen¹⁰

6.1 Aksesimi në financim

Kërkesa e ndërmarrjeve për kredi ka shënuar një rritje të lehtë gjatë periudhës, ku rreth 9% e tyre (krahasuar me 8% në periudhën e kaluar) deklarojnë se kanë aplikuar për financim. Duke e analizuar këtë tregues sipas madhësisë së ndërmarrjeve, rezultoi se peshën më të lartë e zënë ndërmarrjet e mëdha (rreth 11%). Krahasuar me gjashtëmujorin e mëparshëm, vërehet se prirja në rritje e kërkesës për kredi ka ardhur nga ndërmarrjet e vogla dhe ato të mëdha, ndërkohë në grupin e ndërmarrjeve të mesme, kjo kërkesë rezultoi në rënie.


Ndërmarrjet që nuk kanë aplikuar për hua, në shumicën e rasteve, pohojnë kryesisht se nuk e kanë të nevojshme për veprimtarinë që kryejnë (përkatesisht 76% e ndërmarrjeve të vogla, 64% e ndërmarrjeve të mesme dhe 69% e atyre të mëdha) dhe kjo peshë është rritur disi gjatë periudhës. 19% e totalit të ndërmarrjeve kanë vendosur të mos aplikojnë për shkak se procesi u duket i vështirë, dhe kjo peshë ka rënë me 1 pp krahasuar me periudhën e kaluar, e ardhur nga grupi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme; 4% mendojnë se kërkesa e tyre nuk do të miratohet dhe 8% e vlerësojnë më të lehtë huamarrjen nga burime alternative.

Grafik 6.1 Kërkesa për financim e ndërmarrjeve



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Grafik 6.2 Ndërmarrjet që nuk kanë aplikuar për kredi sipas madhësisë



Të pyetur se si do të vepronin nëse nuk do të financoheshin nga bankat, pjesa më e madhe e ndërmarrjeve (rreth 38% e totalit) do ta siguronin këtë financim nga një burim alternativ dhe kjo prirje duket më e theksuar tek ndërmarrjet e vogla (45% e ndërmarrjeve) dhe ato të mesme (41% e ndërmarrjeve), e më pak tek ato të mëdha (35% e ndërmarrjeve). Krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, këto peshë kanë qenë në rënie për ndërmarrjet e mëdha dhe në rritje për ato të vogla. Gjithashtu, rreth 36% e totalit të ndërmarrjeve pohojnë se do t'i drejtohen sërish një banke apo institucioni tjetër, dhe kjo peshë është rritur (me 5 pp), e ardhur nga të tre grupet e ndërmarrjeve, por më e theksuar në rastin e ndërmarrjeve të mëdha. Gjithashtu, në të tre grupet e ndërmarrjeve, vihet re një rënie e peshës së atyre që pohojnë një shtyrje në kohë të planeve të tyre, në kushtet e mungesës së financimit.

¹⁰ Pyetjet e kësaj rubrike i janë drejtuar të gjithë kampionit të ndërmarrjeve, përfshirë edhe ato johuamarrëse.

Grafik 6.3 Mundësitë e financimit në rast mosfinancimi nga bankat




Burimi: Banka e Shqipërisë.

6.2 Procesi i huamarrjes dhe marrëdhënia me bankat


Indeksi i vështirësisë së procesit të huamarrjes nga bankat, për periudhën, ka rezultuar 0.38 për totalin e ndërmarrjeve, duke shënuar rënie në krahasim me periudhën paraardhëse. Ky indeks vijon të mbetet midis nivelit "normal" dhe "i vështirë", për të tre grupet e ndërmarrjeve. Krahasuar me gjashtëmujorin e dytë të vitit 2023, niveli i vështirësisë ka qenë në rënie për të tre kategoritë e ndërmarrjeve.

Grafik 6.4 Indeksi i vështirësisë së marrjes së një huaje nga bankat në vend¹¹



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 6.5 Indeksi i rëndësisë së marrëdhënies me bankat¹²



¹¹ Ky indeks llogaritet duke peshuar përgjigjet e ndërmarrjeve ndaj totalit të përgjigjeve sipas një koeficienti, i cili rritet me rritjen e vështirësisë së këtij procesi. Koeficienti për alternativën "shumë e thjeshtë" = 0, "normal" = 0.25, "i vështirë" = 0.5, "shumë e vështirë" = 0.75, "pothuaj i pamundur" = 1.


¹² Ky indeks llogaritet duke peshuar peshat e përgjigjeve të ndërmarrjeve ndaj totalit të përgjigjeve, sipas koeficientëve që marrin vlerat: 1 për alternativën "e domosdoshme", 0.5 për alternativën "e rëndësishme" dhe vlerën 0 për alternativën "jo dhe aq e rëndësishme".

Marrëdhënia me bankat, e matur nga indeksi përkatës, vijon të vlerësohet midis nivelit “e rëndësishme” dhe “e domosdoshme”, me një vlerë prej 0.73 për totalin e **ndërmarrjeve**. Krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, ky indeks ka shënuar rritje, e ardhur nga të tre grupet e ndërmarrjeve, duke u rikthyer në vlerat e një viti më parë.

6.3 Vështirësia e përfitimit të huasë¹³ dhe planifikimi i huamarrjes

Kostoja e kredisë vijon të konsiderohet si elementi kryesor që vështirëson përfitimin e një huaje bankare, më të theksuar për ndërmarrjet e vogla. Gjatë periudhës, vlerësimi për këtë element ka shënuar rritje për ndërmarrjet e mëdha, ndërkohë që vlerësohet si i pandryshuar për ndërmarrjet e vogla dhe në rënie për ndërmarrjet e mesme.

Grafik 6.6 Niveli i vështirësisë së përfitimit të një huaje



Burimi: Banka e Shqipërisë.


¹³ Për të vlerësuar vështirësinë e përfitimit të një huaje bankare, ndërmarrjeve iu është kërkuar të japin gjykimin e tyre për një sërë elementesh cilësore, sipas një sistemi vlerësimi me 5 shkallë, ku shkalla më e ulët e vështirësisë është 1 dhe shkalla më e lartë është 5. Për të marrë një vlerësim mesatar për secilin element cilësor, shkallët e vlerësimit nga 1 në 5 peshohen me peshat e përgjigjeve të dhëna nga ndërmarrjet.

Nga ana tjetër, si elemente të vështirësisë së përfitimit të huasë listohen dhe “paqartësia e kërkesave të bankës dhe procedurat burokratike” dhe “mungesa e fleksibilitetit nga ana e bankave për ristrukturimin dhe shlyerjen e kredisë”. Ndërkohë që rëndësia e elementit të parë ka mbetur e njëjtë ose në rënie në të tre grupet e ndërmarrjeve, rëndësia e të dytit është vlerësuar në rritje nga ndërmarrjet e mëdha.

Lidhur me planifikimin për huamarrje në gjashtëmujorin e ardhshëm, nga përgjigjet e ndërmarrjeve rezultojnë se kërkesa e tyre për kredi pritet të mbetet në kahun pozitiv, dhe disi në rritje krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar. Kështu, rreth 41% e tyre deklarojnë se ‘nuk ka asnjë mundësi’ që të kërkojnë një kredi bankare gjatë periudhës së ardhshme dhe kjo peshë ka rënë për grupin e ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha dhe ka mbetur e pandryshuar për ato të vogla. Ndërkohë që pesha e atyre që pohojnë në shkallë të ndryshme sigurie (‘ka pak mundësi’, ‘shumë mundësi’ apo ‘është e sigurt’) që të kërkojnë një kredi në gjysmën e dytë të vitit 2024, ka shënuar rritje, duke sinjalizuar rigjallërim të kërkesës së bizneseve për kredi.


Indeksi i vlerësimit të planifikimit të huamarrjes për gjashtëmujorin e ardhshëm¹⁴ rezultojnë në nivelin 0.42 për totalin e ndërmarrjeve, duke shënuar një rritje të lehtë krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar, dhe krahasuar me një vit më parë. Kjo rritje ka ardhur nga të tre grupet e ndërmarrjeve, por ka qenë më e theksuar në rastin e ndërmarrjeve të mesme. Ecuria e indeksit parashikon një rritje të përmbajtur të kërkesës për kredi gjatë pjesës së dytë të vitit 2024, të drejtuar kryesisht nga ndërmarrjet e mesme.

Grafik 6.7 Shpërndarja e ndërmarrjeve sipas planifikimit të huamarrjes



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 6.8 Indeksi i planifikimit të huamarrjes



¹⁴ Për të vlerësuar përgjigjet e ndërmarrjeve është ndërtuar indeksi mbi planifikimin e huamarrjes, llogaritur duke peshuar përgjigjet e ndërmarrjeve ndaj totalit të përgjigjeve sipas një koeficienti, i cili rritet me rritjen e mundësisë së huamarrjes. Koeficienti për alternativën: “nuk ka asnjë mundësi” = 0.25; “ka pak mundësi” = 0.5; “ka shumë mundësi” = 0.75; “është e sigurt” = 1.